

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "Luis III" SHPK

THEMELUESI/T:

1-ANTONELA (PROKO) KARAMETA,e bija e Paskalit,I dtl 16.07.1983,banues I lagjes Nr.5,Kavaje,identifikuar me Nr.leternjoftim ID 034888437 dhe Nr.personal I35716095S. Duke u mbeshtetur ne ligjin 9901,date 14.04.2008,"Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare",me ndryshimet e mevonshme,vendosem te themelojme Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar,sipas kushteve vijuese:

KREU I

OBJEKTI,EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

NENI 1

OBJEKTI I SHOQERISE

- 1.1 Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj: Furre buke

NENI 2

EMERTIMI,SELIA JURIDIKE E SHOQERISE

- 2.1 Ortaket kane vendosur qe te themelojne kete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin : "Luis III" shpk.(Me poshte e quajtur shoqeria).
- 2.2 Selia e Shoqerise ndodhet ne Tirane, Kavaje, KAVAJE, Lagjja nr 1, rruga "Josif Budo", zona kadastrale 8551, pasuria nr 3/399/B.

NENI 3

REGJIMI JURIDIK

- 3.1 Shoqeria eshte SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.Aktiviteti i saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit,Statutit te Shoqerise dhe Legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 3.2 Me vendimin e Ortakeve te Shoqerise,Ortaket mund te ndryshojne Regjimin Juridik te Shoqerise,nese ne te ardhmen krijohen premisa te favorshme per funksionimin e saj,sipas legjislacionit shqiptar.Ne kete rast Ortaket duhet te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise dhe te bejne regjistrimin e ndryshimeve ne Regjistrin Tregtar,prane organit kopetent shqiptar.
- 3.3 Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit,ose Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) ne perputhje me ligjin.
- 3.4 Shoqeria do te kete vulen e saj e cila do te permbaje dhe emrin e shoqerise "Luis III" shpk.

KREU II

TE DREJTAT DHE DETYRIMET,AFATI

NENI 4

TE DREJTAT E SHOQERISE E ORTAKUT

- 4.1 Shoqeria gezon te drejten te lidhe marreveshje dhe kontrata te ndryshme,ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

- 4.2 Shoqeria gezon te drejten te zhvilloje(krijoje) pronesi materiale dhe intelektuale.
- 4.3 Shoqeria ka te drejte te marre pjese,si ortak ne shoqeri apo nderrmarrje te tjera,brenda ose jashte territorit te Shqiperise,ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.4 Shoqeria mban pergjegjesi ndaj te treteve,vetem dhe ekskluzivisht,me kapitalin e saj te derdhur dhe te mirat materiale nga pasuria e saj.
- 4.5 Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informacionet ne raport me aktivitetin prodhues,projektues,te realizimeve tregtare te shoqerise,si bilanci,llogarite ekonomike,etj.
- 4.6 Ortaket kane te drejte te emerojne apo shkarkojne,Administratorin ose Administratoret,Punojes te shoqerise,Ekspertin kontabel,Likuidator.

NENI 5

AFATI (KOHEZGJATJA)

- 5.1 Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje afat te pacaktuar.

KREU III

KAPITALI THEMELTAR,KUOTAT

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

- 6.1 Kapitali themeltar I Shoqerise eshte ne shumen 100.000 leke dhe aktualisht eshte i ndare ne nje kuote te vetme.
- 6.2 Nje kuote me vlere 100.000 leke,qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise,zoterohet nga znj.Antonela Karameta.
- 6.3 Pergjegjesia e ortakeve/ortakut per detyrimet e shoqerise shtrihen deri ne kufirin e vleres se kontributit te secilit ortak ne kapitalin e shoqerise.
- 6.4 Kapitali do te derdhet ne para cash ne banke.

NENI 7

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

- 7.1 Pjeset e Kapitalit Themeltar,jane lirisht te transferueshme,nga Ortaket eshoqerise,te treteve qe nuk jane pjese e Shoqerise.

KREU IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

NENI 8

- 8.1 Shoqeria fiton Personalitet Juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- 8.2 Emertimi i Shoqerise,Kapitali Themeltar,numri i Niptit,duhet te jene te shenuara ne te gjitha aktet e dokumentat qe leshon kjo shoqeri,qe u drejtohen te treteve.
- 8.3 Organet kryesore te shoqerise jane: Asambleja e Ortakeve te shoqerise,Administratori dhe Eksperti kontabel i autorizuar.

NENI 9

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E SHOQERISE

- 9.1 Asambleja e pergjithshme e shoqerise,aktualisht perbehet nga Ortaku i vetem,eshte organi me i larte Vendimarres i Shoqerise dhe Vendimet e tij jane te detyrueshme.
- Te drejtat e detyrimet e Asmablese se Pergjithshme ushtrohen nga Ortaket.Te drejten per te thirrur Asamblene e kane dhe Administratoret dhe Eksperti kontabel i autorizuar.Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet lajmerimit me shkrim ose me email.
- Lajmerimi qofte me shkrim qofte me email duhet te permbaje vendin,daten,oren e takimit dhe rendin e dites.
- Mbledhja e Asamblese mbahet ne nje procesverbal qe permban ndermjet te tjerash dhe Vendimin/et e Asamblese.
- Procesverbalet e mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme ruhen ne seline e Shoqerise.
- Te gjitha Vendimet e Asamblese regjistrohen ne nje regjister te Vendimeve dhe te dhenat e tij nuk mund te ndryshohen apo fshihen.

Ortaket e Shoqerise kane te drejte te marrin Vendime per ceshtje si me poshte:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise;
- b) Ndryshimin e modifikimin e Statutit;
- c) Emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit te Administrimit dhe caktimin e shperblimit te tij/tyre;
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likuidatorileve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe shperblimin e tyre;
- e) Mbikyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise;
- g) Miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit te Shoqerise;
- h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) Perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/eve;
- j) Shperndarjen e fitimeve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- l) Arovimin e rregullave proceduriale te mbledhjes se Asamblese.
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

KREU V **ADMINISTRIMI I SHOQERISE DHE KOMPETENCAT**

NENI 10

- 10.1 Pasuria,veprimtaria dhe aktiviteti i shoqerise do te administrohen nga administratori i emeluar dhe i caktuar nga asambleja e ortakeve te shoqerise,(ortakut te vetem) znj.Antonela Karameta,per nje afat 5 vjecar nga data e ketij akti.
- 10.2 Administratori do te rimbursohet per shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyrave te tij.
- 10.3 Administratori do te ushtroje kompetencat e tij deri ne me te parin nga rastet e meposhtme:
-largimin e tij
-dhe perfundimi i afatit 5 vjecar nga data e fillimit te ketij akti,nese mandati nuk eshte rinovuar.
- 10.4 Administratori gezon te drejten te drejtoje e administratore shoqerine per te arritur realizimin e objektivit te shoqerise.
- 10.5 Administratorit i takon te firmose lirisht dhe te perfaqesoje Shoqerine ndaj te treteve ne veprime,procedura e seanca Gjyqesore,arbitrazhi ose administrative.

- 10.6 Administratori është përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë dhe ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjit, të Statutit ose detyrës të tjera të shkaktuara gjatë ushtrimit të detyrës.
- 10.7 Kompetencat e Administratorit në Shoqëri janë:
- a) Mbikëqyr dhe zbaton politiken e biznesit të Shoqërisë;
 - b) Përfaqëson Shoqërinë;
 - c) Kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standartet e mbajtjes së llogarive;
 - d) Përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e titimeve ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - e) Siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër të detyrueshme sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;
 - f) Siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të pakien një herë në vit nga ekspertë kontabel të çertifikuar dhe raporti i llogaritave publike të çertifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
 - g) Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
 - h) Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhëna të detyrueshme të shoqërisë siç është parashikuar në ligjin për Qendren Kombëtare të Biznesit.
 - i) Kryen të gjitha detyrimet e vendosura nga ligji apo statuti.
 - j) Administrimin e pasurive të shoqërisë, duke përfshirë mjetet financiare brenda kufijve të lejuara nga ortakët e vetëm.
 - k) Kryerjen e të gjithave veprimeve bankare në interes të shoqërisë.
 - l) Të propozojë ortakët të vetëm mbi strukturën e aparatit të shoqërisë, numrin e punësve dhe nëse e shoh të nevojshme të propozojë për krijimin e organeve të tjera, për të realizuar objektivat e shoqërisë.

KREU VI
KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI
VJETOR, DIVIDENTI

NENI 11
KONTROLLI FINANCIAR

- 11.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislationit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emerojë një apo më shumë Ekspertë Kontabel të autorizuar në ato raste ku emerimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 12
VITI FINANCIAR

- 12.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon me datë 1 (një) janar dhe mbaron me datë 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

NENI 13
BILANCI VJETOR

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabel të autorizuar (nëse janë miratuar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si dhe llogaritë vjetore.
- 13.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 14
DIVIDENTI

- 14.1 Pasi te jene permbushur kerkesat e percaktuara nga Ligji per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, Shoqeria me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese se Pergjithshme, mund te vendosi shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.
- 14.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe i bashkangjiten kuotave, te gjithë dividendet duhet te deklarohen dhe paguhen sipas shumave te paguara ne kuotat ne te cilat paguhet dividenti. Te gjithë dividendet do te shperndahen dhe te paguhen ne menyre propocionale me shumat e paguara mbi kuotat gjate cdo pjese ose pjeseve te periudhes ne te cilat paguhet dividenti.

KREU VII
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE, LIGJI I ZBATUESHEM

NENI 15
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

- 15.1 Shoqeria mund te priset ne cdo kohe e per cdo motiv, si ne rastet e falimentimit, privimit te te drejtave te ushtrimit te aktivitetit tregtar, force madhore dhe faktore te tjere te pavarur nga vullneti i ortakeve te shoqerise.
- 15.2 Shoqeria hyn ne fazen e likuidimit nga momenti i prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi (likuidimi), ortakët emerojne nje ose disa likuidatore te cilet i paraqesin nje raport mbi aktivin dhe pasivin e shoqerise, mbi ndjekejn e veprimeve te likuidimit dhe afatin e nevojshem kohor per kryerjen e detyres.
- 15.3 Ne fund te procesit te likuidimit, ortakët e shoqerise vendosin mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi aktet e rregullimit te punes se likuidatorit dhe mbylljen e procesit te likuidimit.
- 15.4 Mas pagimit te kreditorëve dhe cdo detrimi eventual tjeter, pjesa qe mbetet ndahet midis ortakeve te shoqerise.

NENI 16
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

- 16.1 Mosmarreveshjet ndermjet shoqerise dhe te treteve, nese nuk zgjidhen me mirekuptim, atehere zgjidhja e tyre i takon Gjykates se Rrethit Gjyqsor Kavaje.

NENI 17
LIGJI I ZBATUESHEM

- 17.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Akt Themelimi dhe Statutin e shoqerise, si dhe me ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar perkates ne fuqi, per ligjin 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare" me gjithë ndryshimet e mevonshme.
- 17.2 Ky Statut perpilohet e nenshkruhet ne tre kopje me vlere te njejte ligjore. Nje kopje do te qendroje ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

ORTAKET E SHOQERISE "SHEHI KONSTRUKSION" SHPK
Ne kete rast Ortaku i Vetem

ANTONELA (PROKO) KARAMETA

